

REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA E KUNDËRVAJTJES AGENCY FOR ANTI-CORRUPTION	
Emri: _____ Nr. i aktit: <b>DPK/DMP</b> Data: _____ Nr. i referencës: <b>02</b>	Nr. i aktit: _____ Nr. i referencës: <b>03-4392/13</b> Data: _____ Data: <b>23.12.2013</b>

1

KA.nr.1251/2013

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare e Kolegjit, Biljana Rexhiq dhe Dalip Begaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehuri Ali Krasniqi nga Kaçaniku, përmes mbrojtësit, Selim Idrizi- Avokat, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, Regj.nr.2118/2012, të dt. 28.10.2013, në bazë të nenit 31 al.3, 39, dhe nenit 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 29.11.2013, merr këtë:

### A K T V E N D I M

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, Regj.nr.2118/2012, të dt. 28.10.2013 ashtu që ndaj të pandehurit Ali Krasniqi, nga Kaçaniku, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform të nenit 198 al. 1 pika 7 lidhur me nenin 27 al. 1 të Ligjit për Kundërvajtje, për shkak të parashkrimit relativ të veprës kundërvajtëse.

Nga një kopje të aktvendimi duhet dorëzuar palëve në procedurë.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, me aktvendim, Regj.nr.2118/2012, të dt. 28.10.2013, të pandehurin Ali Krasniqi, nga Kaçaniku e ka shpallur përgjegjës sepse:

Si Zyrtari i Lartë Publik, në pozitën e këshilltarit komunal në Ansamblen Komunale në Kaçanik, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit, deri më datën 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 par.1 e sanksionuar, sipas nenit 17 paragrafi 1. pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, për të cilën kundërvajtje konform nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje, ia shqiptoj gjobën në shumë prej 300 (pesëqind) Euro.

Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 5 (pesë) €.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Ali Krasniqi, përmes mbrojtësit, Selim Idrizi-avokat ka paraqit ankesë për shkak të:

-vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe,

-shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse ,

në të cilën përveç tjerash thekson se nuk ka nënshkruar asnjë formularë të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe se njoftimi me email adres dhe me gojë, nuk mund të merret si bazë për ta shpallur fajtor. Se qëllimi i tij nuk ka qenë që ti shmanget deklarinimit ose fshehja e pasurisë, por vetëm vonesa ose neglizhenca duke mos e ditur për pasojat e saj. Si dëshmi ankesës ia ka bashkëngjitur Vërtetimin për deklarinimit e pasurisë të dt.22.08.2012.

Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i goditur të ndryshohet dhe të shpallet i pafajshëm duke e pezulluar procedurën.

Kolegji duke e vlerësuar ankesën e paraqitur aktvendimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës, sipas detyrës zyrtare konstatoi se, për veprën kundërvajtëse me të cilën ngarkohet i pandehuri ka arritur parashkrimi relativ për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse.

Nga provat e deponuara dhe të administruara, ankesa e paraqitur si dhe nga shkresat tjera të lëndës, Kolegji, pa u lëshuar në shqyrtimin faktik të çështjes, konstatoj sipas detyrës zyrtare se për veprën kundërvajtëse me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka ardhur deri te parashkrimi relativ, për shkak se; sipas shkresave të lëndës, dyshohet se kundërvajtja është kryer, me dt.31.03.2012, kurse i pandehuri është ftuar në gjykatë me datën 02.10.2013, gjë që konstatohet në bazë të ftesës të bashkëngjitur shkresave të lëndës e që konsiderohet si datë kur është iniciuar procedura kundërvajtëse. Nga kjo rrjedh se ka kaluar më tepër se një vit nga data e kryerjes së kundërvajtjes, e Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që në afatin ligjor brenda një viti ta inicioj procedurën kundërvajtëse, ashtu si që e parasheh neni 27 al. 1 të LK-së, i cili përcakton se citojmë; “procedura kundërvajtëse nuk mund të ndërmerret, nëse kalon një vit nga koha ku është kryer kundërvajtja”, andaj për veprën kundërvajtëse me të cilën ngarkohet i pandehuri ka arritur parashkrimi Relativ.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, aktvendimi i goditur, NDRYSHOHET, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform të nenit 198 al.1.p.7 lidhur me nenin 27. al.1 të LK-së, për kundërvajtjen nga neni 17 par. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lart Publik, për shkak të parashkrimit relativ të veprës kundërvajtëse dhe i pandehuri Ali Krasniqi, lirohet nga përgjegjësia kundërvajtëse dhe gjoha e shqiptuar.

Konform të nenit 221 të LK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.  
GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
KA. nr.1251/2013, të dt. 29.11.2013.

Procesmbajtësja  
Sebanate Hoti

